



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raport për zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisjen Lokale
për periudhën
Janar - Dhjetor 2024

Prishtinë, 2025

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
ZBATIMI I AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË PËR VETËQEVERISJE LOKALE, JANAR – DHJETOR 2024.....	6
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1.....	6
1.3. Fusha e veprimit: Ndërtimi i infrastrukturës së rrugëve	7
1.4. Fusha e veprimit: Aftësimi i të rinjve, si fuqi punëtore.....	7
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2.....	8
2.1. Fusha e veprimit: Rishikimi dhe krijimi i bazës ligjore.....	8
2.2. Fusha e veprimit: Rritja e efikasitetit në administratën lokale.....	10
2.3. Fusha e veprimit: Pjesëmarrja efektive e qytetarëve në qeverisje	11
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3.....	12
3.1. Fusha e veprimit: Zhvillimi i kapaciteteve profesionale.....	12
3.2. Fusha e veprimit: Ndërtimi i kapaciteteve menaxhuese të administratës	12
3.3. Fusha e veprimit: Përfshirja e shoqërisë civile dhe sektorit privat në ofrimin e shërbimeve	13
3.4. Fusha e veprimit: Mbikëqyrja dhe kontrolli	13
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4.....	13
4.2. Fusha e veprimit: Kultivimi i ndjenjës së vullnetarizmit të qytetarëve.....	13
4.4. Fusha e veprimit: Fuqizimi i shoqërisë civile dhe i bizneseve të reja.....	14
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 5.....	15
5.1. Fusha e veprimit: Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore	15
5.2. Fusha e veprimit: Promovimi i diversitetit etnik dhe gjuhësor.....	16
PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVAVE	Error! Bookmark not defined.
RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE.....	17

Hyrje

Strategjia për Vetëqeverisje Lokale është dokumenti kryesor i prodhuar nga Ministria e Pushtetit Lokal – MAPL i cili fokusohet në vetëqeverisjen lokale në Kosovë. Ky dokument është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin 04/63 të datës 10.12.2016 së bashku me Planin e Veprimit të Strategjisë dhe përfshinë periudhën 2016 – 2026. Strategjia për Vetëqeverisje Lokale është dokument i cili përcakton një kornizë të politikave prioritare të Qeverisë, me qëllim të avancimit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë për një periudhë afatgjate dhjetëvjeçare (2016-2026) dhe është dokument ndër - sektorial.

Në përputhje me Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 dhe me qëllim të përcjelljes së rregullt të zbatimit të kësaj strategjie, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si institucion përgjegjës (koordinues) për implementimin e kësaj strategjie ka nxjerr aktivitetet konkrete nga Plani i Veprimit të Strategjisë për këtë periudhë. Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i procesit të zbatimit të aktiviteteve të cilat dalin nga kjo strategji dhe përcaktimi i hapave për realizimin e detyrimeve të zotuar nga institucionet e Republikës së Kosovës për avancimin e vetëqeverisjes lokale në vend.

MAPL konform përgjegjësi ka monitoruar zbatimin e kësaj strategjie në baza gjashtëmujore. Ky raport pasqyron zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026 për periudhën Janar – Dhjetor, 2024. Raporti u shërben institucioneve të cilat kanë përgjegjësi në zbatimin e kësaj strategjie, organizatave jo qeveritare, organizatave ndërkombëtare, publikut të gjerë dhe jo vetëm. Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026 ka gjithsej 5 objektiva:

- I. **Objektiva strategjike 1** – Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe strukturore lokale për të siguruar që parametrat e politikave lokale dhe modalitetet financiare të sjellin risi në zhvillimin e Komunave;
- II. **Objektiva Strategjike 2** – Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe rregullimin efektiv për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase dhe profesionale të Komunave;
- III. **Objektiva Strategjike 3** – Forcimi i kapaciteteve institucionale të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët;
- IV. **Objektiva Strategjike 4** – Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive;
- V. **Objektiva Strategjike 5** - Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe afirmimi diversitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor në Komuna, të ndikojë në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor.

Përmbledhje ekzekutive

Raporti është i bazuar në 22 tregues që bien në përgjegjësi dhe kompetencë të komunave dhe Ministrive të linjës, për të cilat Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga institucionet konkrete. Megjithatë, kërkesës së raportimit i janë përgjigjur 14 komuna (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Junik, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glllogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë dhe Partesh*).

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me komunat në periudhën Janar-Dhjetor 2024, kanë arritur të realizojnë aktivitetet e parapara që janë pjesë e planit të veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale, të cilat janë analizuar dhe janë vendosur sipas objektivave dhe aktiviteteve të caktuara. Këta tregues janë të bazuar në objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026.

Në këtë periudhë, në kuadër të objektivës strategjike të parë ***“Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe strukturore lokale për të siguruar që parametrat e politikave lokale dhe modalitetet financiare të sjellin risi në zhvillimin e komunave”***, është shënuar progres i matshëm në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, në ndërtim të infrastrukturës së rrugëve dhe në aftësimin e të rinjve si fuqi punëtore.

Fokus i veçantë është dhënë edhe në avancimit të politikave dhe kornizës ligjore për vetëqeverisje lokale, bazuar në objektiven e dytë të strategjisë ***“Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe rregullimin efektiv për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase dhe profesionale të Komunave”***. Në këtë periudhë MAPL ka hartuar 1 projektligj, 1 udhëzim administrativ, 1 doracak dhe 1 manual. Gjithashtu marr për bazë të dhënat e pranuar nga 14 komuna, komunat në vazhdimësi kanë bërë thirrje dhe kanë mbajtur takime publike me qytetarët dhe palët e interesuara në mënyrë që të jenë pjesë e punëve të përbashkëta me strukturat komunale.

Në pajtim me objektiven e tretë të strategjisë ***“Forcimi i kapaciteteve institucionale të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët”*** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Punëve të Brendshme kanë ndërmarrë veprime për zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë fushë. Në këtë drejtim, janë organizuar takime me IKAP dhe donatorë për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna konform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve dhe vlerësimin e nevojave për trajnime.

Bazuar në objektiven katër të strategjisë ***“Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezione”***, MAPL ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026. Gjatë kësaj periudhe në çdo grup themelues për hartimin e politikave dhe legjislacionin e ministrisë është përfshirë edhe nga një anëtarë i shoqërisë civile. Po ashtu, komunat kanë ndërmarrë

veprime për përfshirjen e qytetarëve, në fokus të veçantë nxënësit dhe studentët për të marr pjesë në punë vullnetare.

Implementimi i objektivës së pestë të Strategjisë ***“Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe afirmimi diversitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor në Komuna, të ndikojë në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor”***, nga komunat në vitin 2024 ka pasur ndikim pozitiv në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor. Në kuadër të treguesve të paraparë në këtë objektivë, komunat kanë ndërmarrë veprime si *organizime të panairove për promovim të produkteve vendore, ekspozita artistike, lojëra sportive dhe turnire, aksione vullnetare multietnike, aftësim dhe trajnime kulturore, vizita me të rinjtë për informim dhe njohje me trashëgimi kulturore, janë zhvilluar dokumente si Guida Turistike, buletini ekonomik, harta turistike, janë organizuar kampe multietnike tenisi etj.*

ZBATIMI I AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË PËR VETËQEVERISJE LOKALE, JANAR – DHJETOR 2024

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1 - *Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe strukturore lokale për të siguruar që parametrat e politikave lokale dhe modalitetet financiare të sjellin risi në zhvillimin e komunave*

Për ta ndihmuar zhvillimin ekonomik lokal, Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e MAPL-së dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të linjës, komunat dhe akterët tjerë relevantë ka hartuar Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030. Ky dokument ka për qëllim të lokalizojë orientimet strategjike që dalin nga SKZH dhe PKZH 2030 dhe strategjitë sektoriale që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik. Fushëveprimi i këtij programi kornizohet në adresimin e sfidave të cilat i takojnë nivelit lokal. PNZHEL 2030 do të shërbejë si udhërrëfyes për komunat, ashtu që këto të fundit t'i përgatisin strategjitë e tyre të zhvillimit ekonomik lokal në harmoni me përcaktimet përgjithshme strategjike të SKZH-së dhe PKZH-së, si dhe me dokumentet tjera sektoriale të nivelit qendror. Vizioni i këtij programi është "Krijimi i një ekonomie lokale të qëndrueshme, të larmishme dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve, që sjell zhvillim dhe prosperitet për të gjithë". Për ta arritur këtë vizion deri në 2030-ën, PNZHEL ka paraparë katër objektiva kryesore, të cilat janë: (1) Krijimi i një ekonomie lokale konkurruese; (2) Promovimi i punësimit gjithëpërfshirës; (3) Përmirësimi i infrastrukturës lokale dhe (4) Qeverisja ekonomike efektive dhe bashkëpunuese.

Zhvillimi ekonomik lokal është një proces që ka për qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve, duke nxitur rritjen e investimeve, stimuluar ndërmarrjet me potencial zhvillimi, promovuar krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe duke ngritur infrastrukturën e nevojshme për ta lehtësuar bashkëpunimin midis palëve. Lidhur me këtë Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e MAPL-së dhe në bashkëpunim me institucionet tjera të linjës, komunat dhe akterët tjerë relevantë ka hartuar Planin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030, me qëllim të lokalizojë orientimet strategjike që dalin nga SKZH dhe PKZH 2030 dhe strategjitë sektoriale që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik. Ndërsa për zbatimin e këtij programi, është krijuar komiteti zbatues i PNZHEL, si dhe është mbajtur takimi i parë i komitetit, me ç' rast është përgatitur edhe lista e përgjegjësive të institucioneve bartëse për zbatimin e masave të përcaktuara. Poashtu është realizuar takimi edhe me drejtorët komunal për zhvillim ekonomik lokal lidhur me obligimet e dala nga PNZHEL.

Programet për financimin e projekteve kapitale të komunave janë një ndër instrumentet kryesore të mbështetjes direkte të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik. Për këtë program MAPL ka përgatitur kriteret për financim të projekteve të komunave në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe janë dërguar tek menaxhmenti i lartë. Është lansuar fondi për financim të projekteve më datë 30.01.2024 dhe në kuadër të kësaj thirrjeje janë pranuar aplikimet nga 7 komuna me 9 projekte të cilat janë vlerësuar nga komisioni, është hartuar raporti, si dhe është bërë njoftimi i përfituesve. Për procesin e aplikimit dhe përgatitjen e projekteve për bashkëfinancim me MAPL, është realizuar punëtorja me drejtoreshat komunal. Poashtu marrëveshja për financimin e projektit është nënshkruar me

komunën e Obiliqit dhe në kuadër të kësaj çështjeje është mbajtur punëtoria me menaxheret e projekteve lidhur me implementimin e projekteve, janë realizuar takime teknike me komunën e Obiliqit, për projektin e financuar nga MAPL, si dhe janë realizuar vizitat në terren për verifikimin e progresit të punimeve.

Për programin për mbështetje për projektet infrastrukturore për komunitete, MAPL ka përgatitur kriteret për financim të projekteve të komunave në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal dhe janë dërguar tek menaxhmenti i lartë për aprovim. Lansimi i fondit për financim të projekteve për fazën e parë është bërë me datë 30.01.2024, ndërsa për fazën e dytë është bërë me datë 08.08.2024. Në kuadër të këtyre thirrjeve janë pranuar aplikimet nga komunat, të cilat janë vlerësuar nga komisioni, është hartuar raporti si dhe është bërë njoftimi i përfituesve për të dy fazat. Edhe për këtë program për procesin e aplikimit dhe përgatitjen e projekteve për bashkëfinancim me MAPL është realizuar punëtoria me drejtoret komunal lidhur me implementimin e projekteve. Poashtu marrëveshjet për financimin e projekteve janë nënshkruar me gjithsej 12 komuna dhe në kuadër të kësaj çështjeje janë realizuar takime teknike me komunat përfituese për projektet e financuar nga MAPL, si dhe janë realizuar vizitat në terren për verifikimin e progresit të punimeve.

Në kuadër të bashkëfinancimit me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale, është koordinuar procesi i projekteve me komunat përfituese lidhur me projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për fondet e MAPL-se, si dhe është dërguar lënda e kompletuar me 33 projekte në MFPT për opinion financiar dhe është pranuar opinionin pozitiv nga MFPT. Ndërsa marrja e vendimit të Qeverisë për rialokimin e mjeteve është bërë më dt.12.05.2024. Zotimi për ndarjen e mjeteve financiare është përgatitur.

1.3. Fusha e veprimit: Ndërtimi i infrastrukturës së rrugëve

Treguesi: Janë ndërtuar 90% e rrugëve lokale – janë 11 komuna raportuese (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë*) të cilat kanë raportuar se 90% të rrugëve lokale janë ndërtuar, 1 komunë (*Shtime*) ka raportuar se ka ndërtuar më shumë se 95% të rrugëve lokale, 1 komunë (*Partesh*) ka raportuar se ka ndërtuar vetëm 50% të rrugëve lokale, ndërsa 1 komunë (*Junik*) nuk ka raportuar nëse ka ndërtuar rrugët lokale.

1.4. Fusha e veprimit: Aftësimi i të rinjve, si fuqi punëtore

Treguesi: Në secilën komunë punësohen të rinjtë e aftësuar për punë – bazuar në raportet e pranuar, janë 11 komuna (*Junik, Ferizaj, Deçan, Shtime, Viti, Rahovec, Podujevë, Glogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë*) të cilat kanë deklaruar se gjatë vitit 2024 kanë pasur të rinj të cilët janë punësuar në punë dhe gjithashtu janë trajnuar për t'u aftësuar për punë, 1 komunë (*Partesh*) ka deklaruar se ka të punësuar të rinj në numër jo të kënaqshëm, ndërsa 2 komuna (*Dragash, Klinë*) nuk ka ofruar informacione lidhur me këtë tregues.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2 – *Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe rregullimin efektiv për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase dhe profesionale të Komunave.*

2.1. Fusha e veprimit: Rishikimi dhe krijimi i bazës ligjore

Treguesi: Është bërë harmonizimi i legjislacionit të brendshëm për VQL dhe janë në zbatim - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, fokus të veçantë i ka dhënë zhvillimit dhe avancimit të legjislacionit sipas programit legjislativ për vitin 2024 dhe dokumenteve tjera me ç’ rast ka hartuar aktet si në vijim:


- Ligji Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave - *ky projektligj është hartuar dhe është aprovuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës;*
- Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2024 për Ofrimin e Hapësirave në Objekte të Komunës për Institucionet Qendrore që Ofrojnë Shërbime në Komuna;
- Doracak për përgjegjësitë e komunave që derivojnë nga aktet ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë sektoriale;
- Manuali shpjegues për kriteret dhe procedurat e realizimit të buxhetimit me pjesëmarrje.

MAPL është autoriteti mbikëqyrës i komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato.¹ Procesi i shqyrtimit administrativ të akteve komunale është rregulluar më LVL, dhe Rregulloren (QRK) NR-10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Gjatë vitit 2024, procesit të vlerësimit të ligjshmërisë u janë nënshtruar gjithsej 1948 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave (51 rregullore dhe 1897 vendime). Nga gjithsej 1948 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 1098 akteve, ndërsa 850 akte janë shqyrtuara nga ministrinë e linjës.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Nga gjithsej 1948 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave (51 rregullore dhe 1897 vendime), MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 1098 akteve. Në vijim, përmes diagramit kemi paraqitur të dhënat lidhur me procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL:


¹ Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Kreu X, Nenet 75 dhe 76.



Diagrami 1: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL

Siç shihet edhe nga diagrami i paraqitur më lartë, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 1098 akteve, ku 654 akte janë konfirmuar të ligjshme, dhe 88 akte janë konstatuar të kundërligjshme, nga të cilat komunat pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 70 akte ashtu siç është kërkuar nga MAPL, 11 akte janë shfuqizuar nga komuna, 1 akt është brenda afatit për rishqyrtim, ndërsa 6 akte kanë mbetur të pa rishqyrtuara, të cilat janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë për t'i kundërshtuar në gjykatë, si dhe 356 akte të pranuar nuk i nënshtrohen shqyrtimit të ligjshmërisë.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga ministritë e linjës - nga gjithsej 1948 akte të aprovuara nga kuvendet e komunave (51 rregullore dhe 1897 vendime), Ministritë e Linjës, kanë shqyrtuar ligjshmërinë e 850 akteve. Në vijim, përmes diagramit kemi paraqitur procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave nga Ministritë e linjës:



Diagrami 2: Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga ministritë e linjës.

Siç shihet edhe nga diagrami i paraqitur më lartë, ministritë e linjës kanë shqyrtuar 850 të akteve. Nga këto, 732 janë konfirmuar të ligjshme ndërsa 118 akte janë konstatuar të kundërligjshme. Nga 118 akte të konstatuara të kundërligjshme, komunat kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar 82 akte konform kërkesës për rishqyrtim, 23 janë shfuqizuar nga komuna, 2 akte janë brenda afatit ligjor për rishqyrtim dhe 11 akte janë dërguar në Ministrinë e Drejtësisë.

Treguesi: Në secilin vit bëhet mbikëqyrja e zbatimit të kornizës ligjore, programeve dhe i projekteve nga MAPL në komuna - Sa i përket projekteve në vazhdimësi MAPL ka realizuar takime teknike me komunat përfituese gjithashtu pas nënshkrimit të kontratave nga komunat përfituese me operatorët ekonomik, vizitat në terren dhe verifikimi i punimeve të projekteve janë realizuar sipas situatave të pranura për punët e kryera.

2.2. Fusha e veprimit: Rritja e efikasitetit në administratën lokale

Treguesi: Janë organizuar së paku 20 ditë trajnime në vit për secilën fushë organizative në komuna Në pajtim me objektivat e strategjisë për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht forcimit të kapaciteteve institucionale të komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka ndërmarrë veprime për zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë fushë. Në këtë drejtim, janë organizuar takime me IKAP dhe donatorë për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna konform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve dhe vlerësimin e nevojave për trajnime.

Në bashkëpunim me DEMOS janë realizuar trajnime për koordinatorët e performancës komunale me temën “Raportimi i të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) për vitin 2023 sipas Sistemit të rishikuar, janë realizuar edhe trajnime për zyrtarët raportues në komuna, poashtu është realizuar një trajnim me zyrtarët e informimit me temën "Komunikimi i performancës komunale", si dhe një trajnim me temën “Storjet e suksesit në promovimin e performancës komunale”. Projekti DEMOS poashtu ka përkrahur edhe një trajnim për stafin e MAPL-së me temën "Zbatimi i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK-së) si dhe Grantit të Performancës”

MAPL në bashkëpunim me ZQM dhe OJQ Syri i Vizionit në kuadër të projektit “Detyrimi ynë për të Ardhmen – Mbrojtja e Fëmijëve dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës”, ka organizuar punëtorinë për mbështetje në hartimin e Planit të Punës së Ekipeve të Fëmijëve në Komunat e Republikës së Kosovës duke siguruar që këto plane të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Në këtë drejtim janë mbajtur dy sesione informuese që janë realizuar me kryesuesit dhe sekretariatit të Ekipeve për të Drejtat e Fëmijës. Përkrahur nga Bashkimi Evropian është realizuar trajnimi "Barazia Gjinore" ku zyrtarët nga komunat forcuan aftësitë dhe kapacitetet për t'u angazhuar në mënyrë efektive në qeverisjen me përgjegjësi gjinore dhe anëtarësimin në BE.

Gjithsej janë realizuar 17 sesione trajnimesh, ku përfitues kanë qenë 319 zyrtar komunal.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, janë realizuar 39 ditë trajnime për komunat, ku në total, janë zhvilluar 5 kurse trajnime, me 326 pjesëmarrës. Temat e trajnuara përfshijnë:

Hartimi i shkresave zyrtare dhe Komunikimi shkresor në Administratën Publike – 26 pjesëmarrës
Hyrje në antigijsizëm – 192 pjesëmarrës

Integriteti dhe Etika në Administratën Publike – 51 pjesëmarrës
Menaxhimi i kontratave përmes e-Prokurimi – 29 pjesëmarrës
Siguria në TI dhe Mbrojtja e të dhënave – 28 pjesëmarrës.

Treguesi: Janë organizuar dy ditë trajnime në vit për rolin e komunitetit në qeverisjen e mirë – MAPL në bashkëpunim me Organizatën “Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve”, “Terre des Hommes” dhe “HEKS” ka mbajtur një tryezë diskutimi rreth *“Vlerësimit të kapaciteteve të strukturave komunale të mandatuara për të punuar me grupet e marginalizuara*. Poashtu janë mbajtur 2 sesione me temën *“Korniza monitoruese të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës në komuna”*. Një tjetër punëtori në bashkëpunim me ZQM/ZKM dhe në mbështetje nga OSBE është organizuar lidhur me *“Zbatimin e politikave për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian*. Poashtu është realizuar trajnimi njëditor me temën: *“Hyrje në antigjipsizëm”* ku pjesëmarrës ishin 350 zyrtarë në 14 grupe të ndara.

2.3. Fusha e veprimit: Pjesëmarrja efektive e qytetarëve në qeverisje

Treguesi: Në secilën komunë qytetarët marrin pjesë në punë të përbashkëta me strukturat komunale:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në kuadër të reformave të filluara sa i përket procesit të dixhitalizimit të shërbimeve dhe aktiviteteve komunale ka zhvilluar platformën E-komunat 1, e cila tanimë është integruar në platformën shtetërore E-Kosova dhe do të jetë në shërbim të qytetarëve për rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal, dhe do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale. Në kuadër të kësaj MAPL si udhëheqëse e këtij procesi ka krijuar dhe funksionalizuar Këshillin Koordinues, i cili është këshill gjithëpërfshirës i përbërë nga institucionet relevante publike, organizatat e shoqërisë civile, sektorin e biznesit, organizatat dhe institucionet tjera relevante vendore e ndërkombëtare. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me DEMOS ka përfunduar studimin e fizibilitetit për platformën E-KOMUNAT, platformë e cila është përfshirë në dokumentin Qeveritar në Programin për Zvogëlimin e Barrës Administrative dhe është në proces të integritit në Strategjinë Kombëtare për Digjitalizim. Pas lansimit të fazës së parë të platformës E-KOMUNA, MAPL ka identifikuar nevojën për zhvillimin e shërbimeve të reja, përkatësisht zhvillimin e platformës E-komunat 2, e cila ka është në zhvillim e sipër (ka filluar në tetor 2023 dhe do të përfundojë në tetor 2025).

Gjithashtu MAPL, gjatë vitit 2024 ka monitoruar zbatimin e Udhëzimit të Administratës së Hapur, i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave që sigurojnë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve përfaqësuese në vendimmarrje lokale, transparencën dhe llogaridhënien e organeve të komunës, gjithashtu përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave dhe akteve nënligjore në komunë si dhe obligimet e komunave për të siguruar qasjen nëpërmjet teleprezencës dhe teknologjisë dixhitale për të garantuar transmetimin në distancë dhe monitorimin nga autoritetet qendrore, shoqëria civile dhe qytetarët

Ndërsa sa i përket komunave raportuese, janë 14 komuna (Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Junik, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë dhe Partesh) të cilat kanë raportuar që qytetarët në vazhdimësi marrin pjesë në punë të përbashkëta me strukturat komunale.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3 – *Forcimi i kapaciteteve institucionale të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët.*

3.1. Fusha e veprimit: Zhvillimi i kapaciteteve profesionale

Treguesi: Janë organizuar trajnime për zyrtarët komunal sipas standardeve të kompetencës profesionale – 14 komuna (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Junik, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glllogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë dhe Partesh*) në bashkëpunim me institucionet relevante për trajnim dhe certifikim siç janë *Ministria e Financave, Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP), Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), donatorët*, etj. kanë dërguar zyrtarët e tyre komunal (rreth 100 zyrtarë) në trajnimet (në rreth 70 trajnime) në fushën e:

- Financave (hyrje në sistemin e Menaxhimit të Financave Publike Lokale, moduli i pasurive, moduli i aprovimeve, moduli i të hyrave vetanake, moduli i blerjeve - pranimi të mallit);
- Legjislacionit ();
- Prokurimit (trajnim i avancuar profesional për prokurim, Menaxhimi i kontratave përmes e-Prokurimi);
- Burimeve njerëzore (trajnimi në sistemin e SMBNJ);
- Mbrojtjes së të dhënave (siguria e informacionit, mbrojtja e të dhënave, qasja në dokumente publike,
- Siguri e kibernetike (siguria në TI dhe mbrojtja e të dhënave);
- Menaxhimit të mbeturinave;
- Të drejtave të njeriut (hyrje në antigjipsizëm, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, integrimi gjinor në politikat publike komunale);
- Administratës publike (shkarkimi i barrës administrative, integriteti dhe etika në administratën publike, hartimi i shkresave zyrtare dhe komunikimi shkresor në administratën publike, zhvillimi i politikave publike efektive, procedura e përgjithshme administrative).

3.2. Fusha e veprimit: Ndërtimi i kapaciteteve menaxhuese të administratës

Treguesi: Është bërë vlerësimi i kompetencës profesionale për zyrtarët komunal dhe janë lëshuar certifikata, sipas nivelit të trajnimit dhe arritjeve profesionale – për trajnimet të cilat MAPL ka mbajtur me mbështetjen e donatorëve me zyrtarët komunal, nuk janë lëshuar certifikatat, ndërsa trajnimet të cilat janë mbajtur në bashkëpunim me institucionet relevante për trajnim dhe certifikim, janë lëshuar certifikatat për trajnimet.

Treguesi: Në administratën komunale zbatohet sistemi i vlerësimit sipas arritjeve në punë dhe i shpërblimit për arritje dhe sjellje në punë – Bazuar në të dhënat e 14 komunave raportuese (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Junik, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glllogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë dhe Partesh*) sistemi i vlerësimit sipas arritjeve në punë mënyra vjetore është duke u zbatuar. Lidhur me shpërblimet për arritje dhe sjellje në punë 12 komuna nuk kanë ofruar informacione, 1 komunë (*Glllogoc*) ka ndarë mirënjohje për punëtorët që kanë dhënë kontribut në punë gjatë vitit 2024, ndërsa 1 komunë (*Junik*) ka deklaruar se ka avancuar në detyrë disa nga zyrtarët të cilët kanë treguar arritje në punë.

3.3. Fusha e veprimit: Përfshirja e shoqërisë civile dhe sektorit privat në ofrimin e shërbimeve

Treguesi: Komuniteti merr pjesë aktive në punë të përbashkëta me komunën për rregullimin e jetës komunitare – janë 13 komuna (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë dhe Partesh*) të cilat kanë raportuar që pjesëtarët nga komuniteti përfshihen në mënyrë aktive në punë të përbashkëta, ku komunat kanë specifikuar disa aktivitetet përfshirëse si: takimet publike, dëgjimet buxhetore, buxheti me pjesëmarrje, projektet e përbashkëta me komunitetin, forumet konsultuese të organizuara nga shoqëria civile, iniciativat për mjedisin dhe përmirësimin urban, kontribut në projektet e infrastrukturës si rregullimi i rrugëve lokale dhe ndriçimi publik, pjesëmarrje në pastrimin e lagjeve dhe ruajtjen e mjedisit, bashkëpunim në organizimin e aktiviteteve kulturore, edukative dhe sportive, fushatat vetëdijësuese në fushën e shëndetësisë, barazisë gjinore, sigurisë, parandalimit të dhunës, bullizmit dhe të dukurive të tjera negative, punë vullnetare në mbjellje të pishave apo përgjithësisht për agjendën e gjelbër, përfshirja e rinisë, shoqërisë civile në jetën në komunitet duke iu ofruar mbështetje financiare, e poashtu përfshirja e bizneseve ekzistuese dhe atyre që kanë ide të reja për biznes në zhvillimin e sektorit privat, duke iu ofruar grante, etj. Ndërsa 1 komunë (*Junik*) nuk ka ofruar përgjigje për këtë tregues.

3.4. Fusha e veprimit: Mbikëqyrja dhe kontrolli

Treguesi: Strukturat përkatëse të mbikëqyrjes dhe kontrollit raportojnë rregullisht në çdo tre muaj për mbarëvajtjen e punëve – nga raportet e pranura janë 12 komuna (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glogoc, Skenderaj, Hani i Elezit dhe Partesh*) të cilat kanë deklaruar se hartojnë raportet tre mujore për mbarëvajtjen e punëve ndërsa janë 2 komuna (*Junik dhe Graçanicë*) të cilat nuk kanë ofruar informata për këtë tregues.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4: *Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive*

4.2. Fusha e veprimit: Kultivimi i ndjenjës së vullnetarizmit të qytetarëve

Treguesi: Nxënësit dhe studentët marrin pjesë aktiv në punë vullnetare në pastrimin e objekteve arsimore dhe mjedisit – në 13 komuna raportuese (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Junik dhe Partesh*) kanë ndërmarrë aktivitetet për përfshirjen e nxënësve dhe studentëve për të marrë pjesë në punë vullnetare qoftë në pastrimin e objekteve arsimore apo mjedisore, këto komuna kanë zhvilluar: *aksione lokale për mbrojtjen e mjedisit, pastrimin e parqeve, muzeve, ujërave dhe zonave të tjera natyrore, mbajtje të ligjëratave vetdijësuese në lidhje me kujdesin dhe rëndësinë e një ambienti të pastër dhe modern, pastrimi i terreneve sportive*. Ndërsa 1 komunë (*Graçanicë*) nuk ka ofruar informacione lidhur me këtë tregues.

Treguesi: Grupet rinore dhe sportive marrin pjesë në zbatimin e projekteve të përbashkëta në komunitet – në 12 komuna raportuese (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glogoc, Skenderaj, Hani i Elezit dhe Partesh*) grupet rinore dhe sportive kanë marrë pjesë në zbatimin e projekteve të përbashkëta në komunitet si në rastet: *renovimi i strukturave sportive dhe hapësirave për aktivitete fizike, pastaj fushatat e sëmundjeve dhe stilit të jetesës aktive duke frymëzuar jetë aktive dhe promovuar sportin si pjesë të rëndësishme për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve, organizime të kampionateve, turneve sportive dhe ngjarjeve kulturore bashkë me grupet rinore e sportive e kulturore për komunitetin, aktivitete kulturore në art, muzikë e këngë,*

e poashtu edhe me aksione të ndryshme vullnetare, si pastrimi i hapësirave publike dhe gjelbërimi, mbjellja e pemëve në hapësira publike, pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse, organizimi i olimpiadës speciale të Kosovës me komunitetin e personave me nevoja të veçanta, funksionalizimi dhe promovimi i klubit të futbollit të vajzave, aktivitetet e organizuara për festën e vjeljes së rrushit, dhe ndarje të përvojave dhe organizime të garave në sporte të ndryshme. Ndërsa 2 komuna (Junik, Graçanicë) nuk ka ofruar informacione.

Treguesi: Qytetarët kanë kuptuar rolin e tyre në procesin e planifikimit dhe marrin pjesë në qeverisjen lokale - sipas të dhënave të pranuara janë 7 komuna (Klinë, Deçan, Shtime, Rahovec, Podujevë, Glllogoc, Graçanicë) të cilat kanë organizuar fushata vetëdijësuese për të kuptuar qytetarët rolin e tyre në procesin e planifikimit dhe se qytetarët kanë marrë pjesë në takime, ndërsa janë 6 komuna (Dragash, Ferizaj, Hani i Elezit, Skenderaj, Partesh dhe Viti) të cilat kanë raportuar vetëm për pjesën e dytë të treguesit që qytetarët marrin pjesë takimet e ftuara nga komunat, por sa i përket nëse ata kanë kuptuar rolin e tyre në procesin e planifikuar, komunat nuk kanë paraqitur informacione në lidhje me pjesën e parë të treguesit. 1 komunë (Junik) nuk ka ofruar fare përgjigje në treguesin në tërësi.

4.4. Fusha e veprimt: Fuqizimi i shoqërisë civile dhe i bizneseve të reja

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka vazhduar me përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe në implementimin e strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, ku gjatë kësaj periudhe në çdo grup themelues për hartimin e politikave dhe legjislacionin e ministrisë është përfshirë edhe nga një anëtarë i shoqërisë civile. Gjithashtu është mbajtur një takim i përbashkët me forumin konsultativ për qeverisje lokale.

Treguesi: Komunat në partneritet me bizneset ndajnë bursa për studentë të fushave me nevojë për zhvillimin ekonomik të komunitetit – nga komunat raportuese janë 13 komuna (Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Junik, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glllogoc, Skenderaj, Graçanicë dhe Partesh) që kanë ndarë 2864 bursa për studentet por jo në bashkëpunim me bizneset, 2 nga 13 komuna (Glllogoc dhe Rahovec) kanë ndarë 110 bursa për nxënës dhe studentë në bashkëpunim me bizneset. Si dhe 1 komunë (Hani i Elezit) nuk ka ndarë bursë në bashkëpunim me bizneset.

Treguesi: Ndërmarrësit e rinj aftësohen rregullisht nga komuniteti i bizneseve për hapjen dhe menaxhimin e ndërmarrjeve të reja – nga komunat raportuese 11 komuna raportuese kanë (Klinë, Ferizaj, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glllogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Viti dhe Partesh) kanë kontribuar në aftësimin e ndërmarrësve të rinj në disa forma: përmes trajnimeve/workshopeve, përmes subvencioneve etj. ndërsa 3 komuna (Graçanicë, Shtime, Deçan) nuk kanë ofruar informacione lidhur me këtë tregues.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 5: *promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe afirmimi diversitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor në komuna, të ndikojë në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor.*

5.1. Fusha e veprimit: Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Raporti nga agjenda evropiane për periudhën Janar-Dhjetor 2024 i cili përfshinë 31 komuna raportuese, thekson se lidhur me fushën e trashëgimisë kulturore, sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas të dhënave nga 31 komuna raportuese të komunave janë vetëm 10 komuna (*Shtërpçë, Prizren, Deçan, Dragash, Prishtinë, Graçanicë, Kaçanik, Viti, Obiliq, Rahovec*) të cilat kanë hartuar këtë plan. Arsyet e mosmiratimit të këtij Plani kryesisht kanë qenë: *mungesa e mjeteve financiare, mungesa e sektorit të veçantë të trashëgimisë, mungesa e ekspertëve, stafit* etj. Gjatë kësaj periudhe numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura në 4 Komuna (*Shtërpçë, Prizren, Mitrovicë Jugore, Lipjan*) është 19. Po ashtu, 12 komuna (*Pejë, Junik, Shtërpçë, Prizren, Deçan, Klinë, Gjilan, Ferizaj, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë*) kanë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të objekteve të trashëgimisë kulturore, në 10 Komuna (*Dragash, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, Prizren, Rahovec, Dragash, Prishtinë, Podujevë, Viti, Novobërdë, Kamenicë*) janë siguruar pjesërisht, dhe në 9 komuna (*Glllogoc, Shtime, Malishevë, Partesh, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Partesh, Vushtrri, Hani i Elezit*) nuk janë siguruar pajisjet për monitorim të objekteve të trashëgimisë kulturore. Në 5 komuna (*Shtërpçë, Klinë, Partesh, Ferizaj, Fushë Kosovë*) janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse. Në 20 Komuna tjera nuk janë nënshkruar sepse disa prej tyre nuk kanë kisha. Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar- Dhjetor 2024 komuna e Prizrenit nuk ka alokuar buxhet, ka pasur 3 ndërtime ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit, prej tyre 1 ndërtim, 1 rrënim dhe 1 renovim. Ndërsa komuna e Rahovecit ka themeluar Këshillin e fshatit për Hoqën e Madhe, për të cilin ka ndarë buxhet në vlerë prej 30.670 për vitin 2025, për të mundësuar funksionimin e tij.

Në Komunën e Fushë Kosovës është bërë studimi i fizibilitetit për themelimin e Muzeut të Natyrës i cili është duke u ndërtuar në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por ndërtimi ende nuk ka përfunduar. Gjithashtu me qëllim për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore komunat kanë ndërmarrë aktivitetet të ndryshme. Në 22 Komuna (*Pejë, Junik, Prizren, Glllogoc, Deçan, Rahovec, Prishtinë, Klinë, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, Malishevë, Podujevë, Viti, Partesh, Gjilan, Ferizaj, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Fushë Kosovë, Kamenicë*) janë realizuar këto aktivitete: Promovimi i aseteve të trashëgimisë në media televizive, postimet e fotografive nga asetet e trashëgimisë kulturore, hartimi i hartave zonale dhe shpërndarja e broshurave për promovim të turizmit, vetëdijësimi i qytetarëve, është bërë projekti për restaurimin e disa objekteve të trashëgimisë kulturore, mbështetje e projekteve dhe të individëve, festivale folklorike, aktivitete edukative, kulturore, vizita në muzeume dhe në objektet që janë nën mbrojtje, promovime të ndryshme, etj.

Treguesi: Janë rritë produktet vendore tradicionale: ushqimi, veshjet tradicionale dhe organizimi i panairove për promovimin e këtyre produkteve- 13 komuna (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glllogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë dhe Partesh*) janë rritë produktet vendore tradicionale: ushqimi, veshjet tradicionale dhe organizimi i panairove për

promovimin e këtyre produkteve. Kurse 1 komunë (*Junik*) nuk ka ofruar informacione në asnjërin nga pyetjet.

Treguesi: Janë rritë të hyrat vetanake të komunës dhe është përmirësuar mirëqenia e qytetarëve - Në 11 komuna (*Ferizaj, Deçan, Shtime, Junik, Viti, Dragash, Podujevë, Glllogoc, Skenderaj, Graçanicë dhe Partesh*) ka pasur rritje të të hyrave vetanake të cilat kanë përmirësuar mirëqenien e qytetarëve, 1 komunë (*Skenderaj*) nuk ka ofruar përgjigje në raportim. Ndërsa në 2 komuna (*Klinë, Hani i Elezit*) nuk ka pasur ngritje në vitin 2024.

Për vitin 2024, planifikimi i të hyrave vetanake është në vlerë prej 105,523,577.00€, ku krahasuar me të hyrat e planifikuara për vitin 2023, në vlerë prej 98,519,261.00€, del që planifikimi për vitin 2024 ka qenë më i lartë për 7,004,316.00€, ose shprehur në përqindje 7.10%. Gjithashtu realizimi i të hyrave për vitin 2024 prej 99,583,078.74 €, krahasuar me planifikimin prej 105,523,577.00€ ka një ulje prej 5.63 % krahasuar me vitin 2023 që realizimi kishte rritje prej 11.36%.

Bazuar në ligjet e buxhetit vjetor, të hyrat vetanake në përgjithësi janë rritur nga 79,963,789.00€ në vitin 2016, në 105,523,577.00€ në vitin 2024. Rrjedhimisht kjo rritje ka ndikuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

5.2. Fusha e veprimit: Promovimi i diversitetit etnik dhe gjuhësor

Treguesi: Janë organizuar ekspozita arti, lojëra sportive dhe aksione vullnetare multietnike për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore – 13 komuna raportuese (*Klinë, Ferizaj, Deçan, Shtime, Viti, Dragash, Rahovec, Podujevë, Glllogoc, Skenderaj, Hani i Elezit, Graçanicë dhe Partesh*) kanë organizuar aktivitete si: *ekspozita artistike, lojëra sportive dhe turnire, aksione vullnetare multietnike, aftësim dhe trajnime kulturore, vizita e të rinjve për informim dhe njohje me trashëgimi kulturore, janë zhvilluar dokumente si Guida Turistike, buletini ekonomik, informatori turistik, libri i bizneseve dhe barta turistike, kamp multietnike tenisi etj.* Ndërsa një komunë (*Junik*) nuk ka organizuar ndonjë aktivitet të tillë.

Treguesi: Janë organizuar vizita të turistëve në vendbanimet ku përdoren gjuhë të ndryshme të komunitetit – janë 7 komuna (\) të cilat kanë organizuar vizita turistike me grupe të ndryshme të huaja e vendore duke u ofruar turistëve mundësinë për të mësuar më shumë rreth traditave dhe kulturës lokale, kryesisht në atraksionet më të vizituara turistike siç janë, *Manastiri i Graçanicës* (mbi 200.000 vizitorë) dhe *lokaliteti arkeologjik Ulpiana* (mbi 25.000 vizitorë), *vizita në fshatin Hoçë e Madhe*. Po ashtu, janë organizuar vizita për *ditët e diasporës, ditët e Gjeravicës*, nga Tour Operator - Kroaci me turistë nga e gjithë bota, *ditët e ciklizmit veror*, në fshatin Letnicë, lokalitet ky i banuar me kroat është organizuar “*dita e zonjave*” ku marrin pjesë vizitorë shumë nga shtete dhe qytete të ndryshme. Janë organizuar edhe vizita në *muzeume dhe institucione fetare*, gjithashtu *ekskursione në shkollë dhe qendra kulturore* ku përdoren gjuhë të ndryshme, duke promovuar mësimin dhe ruajtjen e gjuhëve të pakicave, e poashtu edhe *shfaqje të ndryshme teatrale, ekspozitë të artit pamor dhe ligjërata në shkollë të mesme* në Rahovec, me qëllim promovimin dhe ndërëgjegjësimin për rëndësinë e diversitetit gjuhësor. Janë organizuar 2 vizita përmes projektit Nomade Kosova, që ka synuar *zhvillimin e turizmit malor dhe përfshirjen aktive të komunitetit serb në fshatin Runik*, me qëllim të aktivizimit të komunitetit serb në aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin e turizmit lokal. Në kuadër të projektit janë realizuar gjithsej dy vizita. 5 komunat e tjera raportuese (*Dragash, Klinë, Partesh, Podujevë, Shtime*) nuk kanë organizuar vizita për turistët, ndërsa 2 komuna (*Glllogoc dhe Hani i Elezit*) nuk kanë organizuar vizita të turistëve ku

vendbanime ku përdoren gjuhët e ndryshme të komuniteteve për shkak se nuk ka asnjë vendbanim që flitet gjuhë tjetër zyrtare përveç gjuhës shqipe.

Treguesi: Janë organizuar vizita të profesionistëve, shkencëtarëve, universiteteve botërore, etj. për qëllime studimi etj. në institucionet publike dhe kulturore ku përdoret shumë gjuhësia – komunat në përgjithësi kanë organizuar mbi 20 vizita të ndryshme njohëse për grupe të nxënësve, artistë të huaj e vendor, në institucione publike dhe kulturore ku përdoret shumë gjuhësia.

RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Identifikimi i sfidave në vijim është i domosdoshëm për të adresuar progresin dhe për të përmirësuar zbatimin e planit të veprimit:

- Një nga sfidat kryesore ka qenë mungesa e raportimit nga të gjitha komunat. Ky fakt ka bërë që të mungojë një pasqyrë e plotë dhe e saktë e gjendjes reale;
- Përveç kësaj, një tjetër sfidë është mungesa e raportimit dhe angazhimit të të gjitha ministrive në zbatimin e strategjisë. Kjo ka bërë që të ketë mungesë koordinimi në nivel të Ministrive, duke penguar përpjekjet për të arritur qëllimet e përcaktuara në planin e veprimit;
- Gjithashtu një sfidë tjetër ka qenë edhe plani i veprimit, duke e bërë atë të vështirë për tu vlerësuar dhe për të monitoruar në zbatim.
- Funksionalizimi i 5 nëngrupeve punues për zbatimin e Strategjisë, ashtu siç është përcaktuar, në mënyrë që monitorimi të jetë më i rregullt.

Këto janë disa nga sfidat të cilat kërkojnë përpjekje sa më parë për të rregulluar dhe për të përmirësuar procesin e zbatimit të strategjisë për vetëqeverisje lokale.